



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2024:015339

Datë: 18.02.2025

Numri i dokumentit: 06864922

P.nr.24/24

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Blerta Kelmendi, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi Muçaj, në çështjen penale kundër të pandehurit E.A, nga fshati, i Komunës së Pejës, për shkak të veprës penale “*Vjedhje e shërbimeve*” nga neni 314 par.1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë–Departamenti i Përgjithshëm, nën shenjen PP/II.nr.1752/2023, të datës 11.01.2024, pas referimit të çështjes në procedurën e ndërmjetësimit, si dhe pas pranimit të marrëveshjes së ndërmjetësimit të dt. 18.02.2025, në kuptim të nenit 229 par.5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par. 1.3 dhe par. 2 të KPPRK-së, jashtë seancës, me datën 18.02.2025, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET**– marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit me nr. të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.79/25, e datës 18.02.2025, në mes të pandehurit E.A dhe të dëmtuarit KEDS, me seli në Pejë, që përfaqësohet nga Arbon Morina, ashtu që:
- II. HUDHET**, aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.1752/2024, e datës 11.01.2024, ndaj të pandehurit E. (A.) A., i lindur me dt., i identifikuar me letërnjoftim me nr. personal, lëshuar nga MPB – Republikës së Kosovës, i akuzuar për shkak të veprës penale “*Vjedhje e shërbimeve*” nga neni 314 par.1 i KPRK-së, për shkak të arritjes së marrëveshjes së ndërmjetësimit.
- III. PUSHOHET**, procedura penale, kundër të pandehurit E.A, i akuzuar për veprën penale “*Vjedhje e shërbimeve*” nga neni 314 par.1 i KPRK-së.
- IV.** Marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktvendimi, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
- V. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.**

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Pejë – Departamenti i Përgjithshëm me datën 11.01.2024, ka ngritur aktakuzën nën shenjen PP/II.nr.1752/2023, kundër të pandehurit E.A, me vendbanim në rr. “.....”,, fshati, Komuna e Pejës, për shkak të veprës penale ”Vjedhje e shërbimeve” nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 12.08.2024, ka caktuar dhe ka mbajtur seancën fillestare, në të cilën seancë i pandehuri është deklaruar i pafajshëm. Tutje, Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 18.02.2025, në të cilën seancë i pandehuri i ka propozuar gjykatës që kjo çështje penale të referohet në procedurën e ndërmjetësimit, me të cilin propozim përfaqësuesi i palës së dëmtuar është pajtuar. Këtë propozim të pandehurit nuk e ka kundërshtuar as Prokurori i Shtetit Agim Kurmehaj, i cili ka deklaruar se: *pajtohem me propozimin e të pandehurit, jap miratimin që kjo çështje penale të shkoj në procedurë të ndërmjetësimit pasi që i plotëson kushtet.*

Gjykata me datën 18.02.2025, e ka referuar këtë lëndë në procedurë të ndërmjetësimit, në përputhje me Ligjin për Ndërmjetësim i cili në nenin 8, par.1, parasheh se: *“Procedura e ndërmjetësimit mund të iniciohet nga palët, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ sipas legjislacionit në fuqi”, ndërsa në par.2, po të këtij neni parasheh, “nëse rasti gjendet në gjykatë, prokurori apo në organin kompetent administrativ dhe palët pajtohen për të shkuar në ndërmjetësim, gjykata, prokuroria apo organi kompetent administrativ informon dhe udhëzon palët në procedurën e ndërmjetësimit”.*

Poashtu sipas nenit 229 par.1, të KPPRK-së, parasheh se: *“Para ngritjes së aktakuzës, prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet apo me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Pas ngritjes së aktakuzës, me miratim të prokurorit, i dëmtuari dhe i pandehuri apo gjyqtari i vetëm gjykues mund ta referoj çështjen, për këto vepra në ndërmjetësim. Para se ta bëjë këtë, prokurori i shtetit apo gjyqtari i vetëm gjykues merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij dhe nëse ndërmjetësimi është në interes të të dëmtuarit ose viktimës”.*

Ndërkaq, gjykata me datën 18.02.2025, ka pranuar marrëveshjen nga Qendra e Ndërmjetësimit në Pejë, me numër të referencës të ndërmjetësimit ND.nr.79/25, përmes të cilit është njoftuar se në mes të pandehurit E.A si dhe palës së dëmtuar KEDS, me përfaqësues Arbon Morina, është arritur marrëveshja në procedurën e ndërmjetësimit.

Sipas marrëveshjes së arritur në seancën e ndërmjetësimit të mbajtur me 18.02.2025 ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit palët u pajtuan si më poshtë: *Pala "B" (E.A) i kërkon falje palës "A". (KEDS të cilin e përfaqëson Arbon Morina). Pala "A" pranon kërkim faljen nga ana e palës "B". Po ashtu pala "B" deklaroi se pagesën për dëmin e shkaktuar në vlerë prej: 545,94 euro do ta bëjë me 8 kështe nga 68,24 euro për çdo muaj duke filluar nga dt. 15.03.2025 deri në përfundim të borxhit total. Ndërkaq Pala "A" ka deklaruar se në një situatë të tillë ne si palë e dëmtuar pasi që është arritur marrëveshja që rikthimi i humbjes të paguhet, nuk kemi interes juridik që të vazhdohet ndjekja penale.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, e pasi që në rastin konkret Prokurori i Shtetit ka dhënë miratimin dhe pasi që mes pandehurit E.A dhe të dëmtuarit KEDS me përfaqësues Arbon Morina, është arritur marrëveshja e ndërmjetësimit me datë 18.02.2025, gjykata ka analizuar marrëveshjen në fjalë dhe ka gjetur se palët kanë lidhur marrëveshjen e ndërmjetësimit me vullnet të lirë dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-009 Për Ndërmjetësim, përkatësisht nenet 12 dhe 15 paragrafi 1, andaj të njëjtën e aprovoi si dhe ta hedhë aktakuzën e prokurorisë dhe rrjedhimisht ta pushojë procedurën penale ndaj të pandehurit E.A, në kuptim të nenit 229 par. 5 të KPPRK-së¹, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II dhe III të dispozitivit, përkatësisht hodhi aktakuzën dhe pushoi procedurën penale ndaj të pandehurit, duke u bazuar në nenin 229 paragrafi 5 dhe nenin 357 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të KPPRK-së.

Vendimi si në pikën IV, të dispozitivit të këtij aktvendimi, se marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit ndërmjet palëve në këtë çështje penale, është titull ekzekutiv sipas legjislacionit përkatës në fuqi, u mor konform nenit 229 par.6 të KPPRK-së.

Vendimi si në pikën V, të dispozitivit të këtij aktvendimi, lidhur me shpenzimet e kësaj procedure penale u mor konform nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Prandaj, nga sa u tha më lartë, e në kuptim të nenit 229 par. 5 e lidhur me nenin 357 par. 1 nën par. 1.3 dhe par. 2 dhe nenit 453 të KPPRK-së, dhe nenin 12 dhe 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësimin, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - Divizioni Penal
P.nr.24/24, me datë 18.02.2024.

Gjyqtarja e vetme gjykuese

Blerta KELMENDI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej tri (3) ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi.

¹ Me marrjen e njoftimit për arritjen e marrëveshjes, prokurori i shtetit e hedh kallëzimin penal ose e ndërpre në procedurën penale. Nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.